
KOMUNA E JEGUNOVCIT



FLETORJA ZYRTARE
E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Botohet sipas nevojës	**Numër 54**	**17.04.2025**

JEGUNOVC, PRILL 2025

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2025

Shpallet Konkluzioni për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 17.04.2025.

Nr. 09-914/1
17.04.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së", nr. 5/02 dhe"Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 202/24) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit",nr. 21/03), kurse në pajtim me nenin 32 të Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së"nr 61/2004, 96/2004, 67/07,156/09, 47/2011, 192/15, 209/2018 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së"nr. 244/19, 53/21, 77/21, 150/21 dhe 170/24), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetekatër të mbajtur më 17.04.2025, mori

KONKLUZION

për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2025

1. Miratohet Raporti financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2025.

2. Ky Konkluzion hyn në fuqi ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-895/3
17.04.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d. v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për miratimin e Planit operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

Shpallet Vendimi për miratimin e Planit operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 17.04.2025.

Nr. 09-914/2
17.04.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 10 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) të nenit 21-a paragrafi 1 pika 11-a të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetekatër të mbajtur më 17.04.2025 mori,

V E N D I M

për miratimin e Planit operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Plani operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025.

Neni 2

Plani operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025 nga neni 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi dhe i njëjti nuk shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-895/4
17.04.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d. v .

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Jegunovcit dhe Komunës së Zhelinës

Shpallet Vendimi për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Jegunovcit dhe Komunës së Zhelinës, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 17.04.2025.

Nr. 09-914/3
17.04.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 4 paragrafi 3 dhe neni 7 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 79/09) dhe nenit 14 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 5/02 dhe"Gazeta Zyrtare e RMV-së",nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Jegunovcit"nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetekatër të mbajtur më 17.04.2025 mori:

VENDIM

për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Jegunovcit dhe Komunës së Zhelinës

Neni 1

Me këtë Vendim vendoset bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Jegunovcit dhe Komunës së Zhelinës.

Neni 2

Bashkëpunimi ndërkomunal nga neni 1 i këtij Vendimi do të realizohet përmes kryerjes së punëve të caktuara nga ana e njërës komunë për komunën tjetër për inspektor nga lëmi i ndërtimeve, inspektor i veprimtarisë hotelerike dhe turistike dhe inspektor i arsimit.

Neni 3

Për realizimin e bashkëpunimit ndërkomunal do të lidhet kontratë në mes të dy komunave të përfaqësuar nga kryetarët e komunave për kryerjen e punëve të caktuara nga ana e njërës komunë për komunën tjetër, lidhur me dispozitat e nenit 9 paragrafi 2 alineja 2 dhe nenit 29 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal ("Gazeta Zyrtare e RM-së",nr. 79/09).

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-895/5
17.04.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje

Shpallet Vendimi për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 17.04.2025.

Nr. 09-914/4
17.04.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr.202/24), kurse në pajtim me Ligjin për plotësimin e Ligjit për rrogat dhe kompensimet e tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë („Gazeta zyrtare e RSM „ nr. 36/90 dhe Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 38/91,23/97,37/05,84/05,121/07,161/08,92/09,42/10, 97/10,161/10, 11/12, 145/12, 170/13, 139/14, 233/18 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së„ nr. 51/23, 65/23 dhe 51/24), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pesëdhjetekatër të mbajtur më 17.04.2025 mori:

V E N D I M
për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet kompensimi mujor për anëtarët e Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit.

Neni 2

Kompensimi mujor për anëtarët e Këshillit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e saj vërtetohet në shumë prej 40% nga rroga mesatare neto mujore në RMV e paguar vitin e kaluar.

Kompensimi mujor i anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit është 16.495 denarë.

Neni 3

Kryetarit të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për udhëheqjen dhe organizimin e punës së Këshillit kompensimi nga neni 2 i këtij Vendimi rritet për 30% dhe do të jetë 21.443 denarë.

Neni 4

Kompensimi mujor nga neni 2 I këtij Vendimi për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit paguhet për pjesëmarrje në të gjitha mbledhjet e Këshillit për muajin rrjedhës.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit zvogëlohet për 30% për çdo mungesë nga mbledhja e Këshillit.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit nuk paguhet nëse anëtari i Këshillit nuk ka marrë pjesë në asnjë mbledhje të Këshillit gjatë muajit rrjedhës.

Kompensimi mujor për pjesëmarrje në mbledhje nuk do të paguhet nëse Këshilli në muajin rrjedhës nuk do të mbaj mbledhje.

Neni 5

Anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit do t'ju paguhet kompensim për harxhime rruge dhe ditore për udhëtime zyrtare në vend dhe në botën e jashtme sipas dispozitave të cilat u përkasin nëpunësve shtetëror, të punësuar në administratën komunale të Komunës së Jegunovcit.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit" kurse do të zbatohet nga prilli 2025.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi ndërpritet të vlejnë Vendimi i Këshillit nr. 08-738/4 të datës 18.04.2024 ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit", nr. 37/2024).

Nr. 08-895/6
17.04.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetari
Perica Saveski, d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (" Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 5/02 dhe" Gazeta zyrtare e RMV-së'' nr. 202/24) dhe nenit 109 paragrafi 4 të Ligjit për arsimin fillor ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 161/2019, 229/20 dhe 3/2025), kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 08.04.2025, mori:

A K T V E N D I M

për shkarkim nga funksioni ushtrues detyre drejtor i SHFK" Simçe Nastovski", nga f.Vratnicë

1. Dean Trpevski shkarkohet nga funksioni ushtrues detyre drejtor i SHFK" Simçe Nastovski", nga f.Vratnicë, përfundimisht me datën 08.04.2025, për arsye të shpalljes paraprake të konkursit publik dhe zbatimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit , kurse nga ana e Këshillit të shkollës së SHFK „Simçe Nasteovski'' f. Vratnicë, është miratuar propozim-Vendim për kandidat për drejtor të SHFK „Simçe Nasteovski'' f. Vratnicë

2. Me hyrjen në fuqi të këtij Aktvendimi ndërpritet të vlejë Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Jegunovcit për emërimin e ushtrues detyre drejtorit nr. 09-358/1 të datës 13.02.2025

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

A r s y e t i m

Dean Trpevski, me Aktvendim të Kryetarit të Komunës së Jegunovcit nr. 09-358/1 të datës 13.02.2025 u emërua ushtrues detyre drejtor i SHFK" Simçe Nastovski", nga f.Vratnicë me mandat 6 mujor.

Dean Trpevski ushtrues detyre drejtor në SHFK "Simçe Nastovski", nga f.Vratnicë i përfundon funksioni i drejtorit përfundimisht me 08.04.2025 për arsye të shpalljes paraprake të konkursit publik dhe zbatimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit , kurse nga ana e Këshillit të shkollës së SHFK „Simçe Nasteovski'' f. Vratnicë, është miratuar propozim-Vendim për kandidat për drejtor të SHFK „Simçe Nasteovski'' f. Vratnicë

Nga shkaqet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Aktvendimi hyn në fuqi ditën e marrjes.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit nëpërmjet kryetarit të Komunës së Jegunovcit deri tek Komisioni kompetente për procedura administrative, procedura për marrëdhënie pune dhe mbikëqyrje inspektuese të shkallës së dytë.

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gaz. zyrtare e RM„ nr. 5/02 dhe „Gaz. zyrtare e RM„ nr. 202/24), neni 48 të Ligjin për entet ("Gazeta zyrtare e RM", nr.32/05,120/05 dhe 51/11) kurse në pajtim me nenin 115 paragrafi 14 të Ligjit për arsimin fillor ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 161/2019,229/2020 dhe 3/2025),kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 09.04.2025, mori:

AKTVENDIM

për emërimin e Drejtorit të SHFK"Simçe Nastovski" nga f.Vratnicë

1. **Dean Trpeski** emërohet Drejtor i SHFK"Simçe Nastovski" nga f.Vratnicë.

2. Mandati i drejtorit të emëruar nga pika 1 e këtij Aktvendimi fillon të rrjedh prej 09.04.2025 dhe do të zgjat 4 vjet, kurse për këtë periudhë kohore vendi i tij i punës arsimtar i Gjuhës maqedone në paralelet shqiptare në SHFK"Simçe Nastovski" nga f.Vratnicë SHP f. Jazhincë do ti pushojë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes, do të zbatohet nga 09.04.2025 kurse do të shpallet në „Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Arsyetim

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gaz. zyrtare e RM„ nr. 5/02 dhe „Gaz. zyrtare e RMV-së„ nr. 202/24), neni 48 të Ligjin për entet ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 32/05,120/05 dhe 51/11) kurse në pajtim me nenin 115 paragrafi 14 të Ligjit për arsimin fillor ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 161/2019,229/2020 dhe 3/2025),kryetari i Komunës së Jegunovcit me propozim të Këshillit të shkollës së SHFK"Simçe Nastovski" nga f.Vratnicë nr. 0202-108/2 të datës 28.03.2025 mori Aktvendim si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur në afat prej 8 ditësh nga dita e Aktvendimit të kryetarit të Komunës, ka të drejtë ankese ne lidhje me zbatimin e procedurës për shkarkimin deri te Komisioni kompetente për procedura administrative, procedura për marrëdhënie pune dhe mbikëqyrje inspektuese të shkallës së dytë

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

P ë r m b a j t j a

Aktvendimi për shpalljen e Konkluzionit për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2025.....1
Konkluzioni për miratimin e Raportit financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit për kuartalin I-rë të vitit 2025.....2

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për miratimin e Planit operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025.....3
Vendimi për miratimin e Planit operativ për mbrojtje dhe siguri nga përmbytjet në Komunën e Jegunovcit për vitin 2025.....4

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Jegunovcit dhe Komunës së Zhelinës.....5
Vendimi për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Jegunovcit dhe Komunës së Zhelinës.....6

Aktvendimi për shpalljen e Vendimi për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje.....7
Vendimi për caktimin e kompensimit mujor të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Jegunovcit për pjesëmarrje në mbledhje.....8

Aktvendimi për shkarkim nga funksioni ushtrues detyre drejtor i SHFK" Simçe Nastovski", nga f.Vratnicë.....10
Aktvendimi për emërimin e Drejtorit të SHFK"Simçe Nastovski" nga f.Vratnicë.....11